Per rastin kur sheshi ne dipozicion, nuk e mundeson ndertimin e pandusit brenda tij, kemi parashikuar jashte nje pjacolle per ambulancen te plotesuar me sinjalistiken per personat me aftesi te kufizuar.

e. Per rrethimet e jashtme; kur ekzistojne kemi parashikuar riparime e plotesime dhe lysterje duke e sjelle ne parametra bashkekohore, ne rastet kur ai mungon dhe kushtet e lejojne kemi parashikuar rrethim te ri duke vleresuar koston per 1 ml, me analize. Per rastet kur objektet jane ne terene te pjerett dhe jane mesyre nga prurjet e ngurta nga larte, kemi parashikuar qe te qe struktura e murit mbajtes te plotesoje dhe kerkesen per pritjen e dherave nga larte, nderkohe eshte parashikuar largimi i prurjeve.

8. Instalimet Hidrosanitare dhe ngrohjes.

Parashikohet qe ne mjediset e punes te kete uje te ngrohete dhe te ftohte, i siguruar nepermjet instalimit te nje lavamani me bojler elektrik 12 litersh. Rrjeti i furnizimit me uje ekzistues parashikohet te cmontohet 100%. Te njejtin qendrim kemi mbajtur dhe per shkarkimet e brendshme; jane parashikuar te ndertohen te reja ne pershtatje me shperndarjen e lavamaneve ne mjediset e punes. Ne plotesim te kerkeses se Drejtorise se shendetit publik, kemi parashikuar dhe furnizimin me uje edhe ne ratet kur ai mungon ne rrjet. Kemi parashikuar depozita 500 dhe 1000 litershe ne varesi te mjediseseve. Depozitat do te jene plastike dhe do vendosen nen cati. Tubi mbrojtes ne cdo rast do te perfundoje ne ulluket e catise .

Ne shumicen e qendrave dhe ambulancave nuk ka uje te rrjedhshem per pasoje nuk ka dhe shkarkime, kjo per faktin se dhe fshati nuk ka te tilla; e megjithate qendrat shendetesore apo ambulancat kane instalime te brendshme deri dhe gropa septike por qe nuk funksionojne. Per rastet kur ka kanalizim te jashtem kemi parashikuar punime per rregullimin dhe plotesimin e pusetave dhe gropave septike ekzistuese; kur nuk ka te tilla i kemi parashikuar keto si dhe lidhjen midis tyre me tub shkarkimi PCV me diameter 140 mm.

Shume fshatra aktualisht nuk kane furnizim me uje te pijshem pasi ende nuk jane ndertuar ujesjellesa, gjithashtu nuk kane as kanalizime; e megjithate qendrat shendetesore apo ambulancat kane instalime te brendshme deri dhe gropa septike por qe nuk funksionojne.

9. Instalime elektrike, telefonike, kompjuterike, mbrojtjes kunder zjarrit dhe i ngrohjes.

Rrjeti elektrik ekzistues nuk shfrytezohet, hiqet ne masen 100 %, Ndertohe sipas standarteve te kohes rrjetet elektrik, kompjuterik, telefonik dhe te sinjalizimit te rrezikut te zjarrit, parashikohet dhe ndricim emergjence. Rrjetet e ndricimit, te prizave, te bojlereve dhe te kondicionereve jane te ndare nga njeri tjetri. Energjia stakohet komplet ne kuadrin elektrik ne hyrjen e objektit. Rrjeti kompjuterik, i telefonise dhe i sinjalizimit te rreziku te zjarrit shkojne ne cdo dhome.

10. Preventivi

Cmimet në preventiv janë vendosur , sipas manualit të vitit 2015. Per zërat e punimeve qe nuk përfshihen në manual, kemi hartuar **analiza (An) të vecanta cmimesh**, qe jane pjese e dokumentacionit të **projektit**.

Struktura e preventivit eshte ndertuar ne menyre te tille qe investitori apo enti prokurues , mund te nderhyjne ne objekt dhe te rikonstruktojne nje apo disa elemente, ne pershtatje me mundesite financiare qe ka. Elementet jane grupuar ne menyre te tille qe, rikonstruksioni i nje elementi apo disa te tilleve eshte perfundimtare, Realizimi rikonstruksionit te elementeve te tjere nuk cenojne rikonstruksionet e meparshme por i plotesojne ato.

Per punimet qe prishen dhe ribehen, kemi hartuar analizen e cmimit qe perfshin te dy operacionet. Kjo lehteson procesin e matjeve dhe eliminom abuzivitet gjate procesit te zbatimit pasi eliminon proces verbalet e punimeve me shume e me pak.

Per : BOE "TAULANT" SHPK

&

"HMK-CONSULTING" SHPK

Ing. Ditika Qatipi



" VIANTE Konstruksion " Sh.p.k.
RELACION SHPJEGUES I PROJEKTIT

*Hartimi i Projekt-Preventivit të zbatimit për
rikonstruksionin e godinave të qendrave
shëndetësore dhe ambulancave*

Qendra Shëndetësore Lagja: M. Alimani

Rikonstruksioni i kësaj qendre vjen si rezultat i pasjes së një qendre shëndetësore me funksionim normal dhe me standarte të përcaktuara.

Gjendja ekzistuese ofron kushte shumë të vështira pune dhe jashtë standarteve teknike, gjë që vë në rrezik si punonjësit ashtu edhe pacientët të cilëve i ofrohet shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor.

Qëllimi i këtij rikonstruksioni është krijimi i një qendre shëndetësore, ku të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme të shërbimit parësor shëndetësor, rikonstruksionin e plotë dhe rivitalizimin e godinës ekzistuese, si edhe krijimin e një ambjenti të brendshëm dhe të jashtëm si funksional ashtu edhe estetik, me vlera bashkëkohore dhe funksionale.

Projektuesi ka bërë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstruksionin e godinës duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së Institucionit, skemën funksionale të saj, si dhe duke harmonizuar me godinat e tjera të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme.

Sistemimeve të jashtme të objektit i është kushtuar një rëndësi e veçantë, gjithmonë duke patur parasysh nëse territori përreth godinës është në pronësi të vetë qendrës shëndetësore. Ato janë projektuar në përputhje me të gjitha normat e sigurisë dhe standardet e projektimit. Ambjentet e jashtme janë kryesisht ambiente që shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë i është dhënë krijimit të një sipërfaqeje të gjelhër dhe me pemë.

Një pikë e rëndësishme në hartimin e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës githashtu është edhe përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuar të cilës i është dhënë rëndësi e veçantë, duke realizuar me elementët ndërtimor si pandusi i hyrjes nga niveli i tokës sistemuar deri në kuoten $+0.00$ me pjerrësi max. 5 deri 8 % konform VKM nr.1503 datë 19.11.2008 mbi "Shfrytëzimin e hapsirave nga personat me aftësi të kufizuar", si dhe janë parashikuar të gjithë elementët e tjerë ndërtimor të sinjalitika horizontale dhe vertikale me qëllim që godina e rikonstruktuar të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të vecanta.

Përshkrim mbi punimet kryesore të rikonstruksionit që do të kryhen:

A-Punimet për infrastrukturën ndërtimore.

1. Është parashikuar prishja e të gjithë suvatimeve të brëndshme të cilat janë të amortizuara. Suvatimet e reja do të ribëhen konform K.T.Z. për këtë proces si dhe bazuar në detyrën e projektimit për rikonstruksionin e këtij objekti.
2. Do të behet riparim çatie ne masen 50% te siperfaqes se saj.
3. Shtresat e pllakave ekzistuese janë të amortizuara, dhe të disa llojeve për shkak të ndërhyrjeve pjesore që janë kryer në objekt. Gjithashtu shtresat ekzistuese do të hiqen edhe për faktin se do të vendosen (shtrihen) nën to linjat e reja për instalimet elektrike, H/Izolimit të nyjeve higjeno-sanitare etj. Në punimet e shtresave bëjnë pjesë dhe veshja e re e shkallëve me mermer graniti të cilësisë I dhe montimi i korimanove prej inoksi në shkallë dhe shesh pushimet. Për rrjedhojë të gjitha shtresat e dyshemeve do të bëhen të reja, duke i shtruar me pllaka cilësore të ngjitura me kollë. Ambientet e tjera sanitare me pllaka grez porcelanato me siperfaqe poroze. Ngjyra dhe lloji i pllakës do të përcaktohen nga projektuesi dhe investitori. Në të gjithë ambientet ku shtrohen pllaka do të ketë dhe F-v plintusa me h=10 cm si vetë pllaka.
4. Në punimet e ribërjes së suvatimeve të reja kujdes i vecantë do ti kushtohet cilësisë së suvatimit. Siperfaqja e re e suvatuar përpara lysterjes do të pastrohet mirë me zmerilim me letër dhe do të lyhet me 1 dorë prajmer dhe 2 duar hidromat plastiko (cil.I) pa përmbajtje të elementëve bakterial si dhe do kryhet lysterja me bojë akrilike të mureve të brendshme nga dyshemeja deri në lartësinë 150 cm.
5. Të gjitha ambientet e nyjeve sanitare do të vishen me pllaka të reja deri në lartësinë 2m. Në këto ambiente pas realizimit të shtresës niveluese të llustrës me t-mesatare 2-3cm, ato do të hidroizolohen me emulsion me dy duar bitum, ku lartësia e h/izol mbi kuoten e dyshemesë së nbaruar të nyjes sanitare, do të jetë deri rreth 50 cm. Mbi shtresën do të realizohet shtresa e e dytë e llustrës me t=2 cm. Llustra detyrimisht të jetë llustër cemento në raport 1:2 (çerë/cimento).
6. Në muret e katit përdhe ka shenja lagështie (kapilaritet të ujit) për rrjedhojë do të kryhen panime të cilat do të disiplinojnë prezencën e lagështisë në muret e katit përdhe.
7. Si të tilla do të jenë punimet e sistemimeve të jashme në zonat të vecanta ku do të kryhen punime e reja, sic është ndërtimi i sistemit të ri ujëmbledhësi për ujrë sipërfaqësor duke ndërtuar kunetë të re mbrojtëse me b/arme M-200Kg/cm² e mbuluar me zgarë metalike. Do të bëhet trotuari perimetral rreth godinës të shtruar këto me pllaka betoni me ngjyra.
8. Në fasadën e suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të behet veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e

lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agentëve atmosferik.

9. Lidhur me furnizimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve në objekt është parashikuar që ato të vendosen të reja. Dritaret do të jenë duro plastike me dopio xham dhe gominë nga të dy anët, me hapje me rrotullim dhe praktike në pastrim. Lidhur me ngjyrën e dritareve ajo do të realizohet e bardhë duke qëndruar uniformë me godinat tjera e këtij funksioniden. Në proj. dhe prev. është parashikuar të vendosen dhe montohen rrjetë mizash në elementët e dritares, të projektuara si të hapëshme (kanata apo sopra luce). Në pjesën e kontaktit të dritares me davancalin e mermerit të bëhet silikonimi për të penguar depërtimin e ujit. Dyert rekomandohen të jenë me ngjyrë të celet. Dyert e nyjeve sanitare për mbylljen e tyre të jenë me shul të inkasuar në derë (jo me celës).
10. Realizimi i detajeve ndërtimore për Personat me aftësi të kufizuar(p.a.k.), për ndërimin e pandusit do realizohet me themel e xokol betoni C- 12/15 në rastet e kur disnivele është më pak se 50 cm dhe me soleta të plota b/a C 20/25 me trashësi 10 cm për lartësitë deri në 4 m

B- Punimet instalatore dhe teknologjike.

1- Punimet elektrike.

Në projekt preventivin bashkëngjitur, do të gjeni fletët e projektit të detajuara për punimet elektrike. Punimet elektrike janë parashikuar të ribëhen të reja për arsye të amorizimit të atyre ekzistuese, si dhe për garantimin e rritjes së fuqisë së re të instaluar, e cila do të shoqërohet dhe me ndërhyrje dhe rinovim të automatëve kryesor në kabinën elektrike ose në secilin kat.

Për zbatimin e punimeve të reja elektrike, materialet e perdurura duhet të jenë konform normave të projektuara (shikoprojektin) si dhe kërkesave bashkëkohore të C.E por dhe ato shqiptare të përshtatura për këto punime. Kujdes i vecantë duhet ti kushtohet realizimit të sistemit të tokëzimit. Ndriculesat në dhoma janë parashikuar të vendosen mbi kokën e pacientit në h=2.5 m dhe të komandushëm nga ky i fundit me celes 1 polar me h=1m nga dyshemeja. Ndricimi në koridore dhe në ambientet e tjera është parashikuar të realizohet me llampa ekonomike (luminishente) dhe të llojit sic përcaktohen në projekt.

2- Punimet e kondicionimit Ngrohje-Ftohje.

Për sistem ngrohje në periudhën e dimrit është përdorur ngrohja me gaz vetëm në disa ambiente duke plotësuar vetëm 20% të nevojave godinës. Nisur nga kjo situatë u projektua një sistem Ngrohje-Ftohje dhe Aspirimi me kondicioner inverter

3- Instalimet H/sanitare dhe shkarkimeve.

Për instalimet H/sanitare është parashikuar që keto të ribëhen komplet të reja për shkak të amortizimit të tyre, por dhe mosgarantimit në vazhdimësi funksionimin normal për shkak të cilësisë së dobët që kanë pasur këto tubacione dhe pajisje të cilat në kushtet e sotme nuk plotësojnë as parametrat më minimal të standarteve shqiptare të përshtatura me normat dhe ISO-t e CE. Pajisjet H/S janë parashikuar të jenë me material porcelan. Tubat e shkarkimit do të jenë tub PPV 40x3.2mm referuar iso/dis 3633.tubat e shkarkimeve vertikale do jenë me tuba PVC me spesor 3mm.Bashkimet

të bëhen me ngjitës pvc të lëngshëm special. Kollonat vertikale do të dalin për cfryrje të gazrave në taracë.

Ndër punimet e tjera H/sanitare janë dhe tubacionet e furnizimit dhe të shpërndarjes me ujë të pishëm. Furnizimi i objektit me ujë është parashikuar të bëhet në dy mënyra, me furnizim direkt nga rrjeti dhe sitem të kombinuar rezervuar-pompë shtytëse me rezervuar xingato 5000 l c-2-3 dhe pompa shtytëse me kap. $Q=120\text{l/min}$ dhe $h=30\text{m}$. Njëri nga rezervuarët dhe 1 pompë do të shërbejë i pavarur dhe enkas për sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Tubacionet do të jenë prej material polipropileni dhe ngjitje me të nxehtë në gjatësi dhe bashkuese polipropileni me fileto. Objekti do të paiset me kontaktor (matës) të ri. Tubat do të kenë diametra sic janë në projekt nga $D=20 \times 4.1\text{mm}$ deri $d=63 \times 10.5\text{mm}$. Para përfundimit të shtresave të bëhen provat me ngarkesë me presion max 1.5-2 atm se presioni normal. Furnizimi i pompave të ujit me energji të garantohet duke u lidhur dhe me burimin rezervë të energjisë gjeneratorin dizel. Për rastin e furnizimit me ujë të vendosen saracineska bronxi kontrolli dhe funksionale në raste avarie. Gjithashtu janë planifikuar të vendosen pika kontrolli me fileto ose gominë në tubacionet e shkarkimit ujrave të zeza. Tubacionet e ujit të pishëm mbi tavanet dhe në mure të sistemohen me konstruksione metalike ose të kapura me grapeta cdo 1.5m.

SHENIM:

Për sqarime dhe detajime më të hollësishme përvec se ato që përshkruajnë projektet e zbatimit dhe preventivi, si dhe specifikimet teknike përkatëse, për cdo paqartësi apo sygjerim të mos veprohet pa u konsultuar paraprakisht me investitorin dhe supervizorin. Pjesë e dokumentave për porositesin është dhe grafiku i punimeve i hartuar nga grupi i projektimit i cili përcakton kohëzgjatjen e punimeve

Për të gjitha punimet e përshkruara më lart dhe në vazhdim sipërmarrësi do të hartojë plan organizimin e punimeve i cili duhet të shërbejë jo vetëm si masë organizative për realizimin e punimeve në afat, por edhe për aktivitetin normal të veprimtarisë së qendrës dhe përreth tij, por njëkohësisht dhe si tregues dhe zbatues i masave për sigurimin teknik të Specialistëve + Puntorëve të zbatimit, si dhe të personelit që lëviz përreth objektit. Për të gjithë zërat e punimeve të përshkruara në preventiv dhe projekt sipërmarrësi është i detyruar të kryej punimet e zbatimit, konform një plan organizimi të punimeve në kantier si dhe ligjeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë **KUSHTET TEKNIKE TE ZBATIMIT (K.T.Z) TË PRODHIMIT DHE FURNIZIMIT ME MATERIALE** të certifikuar **KONFORM NORMAVE SHQIPTARE** sipas STASH dhe të përshatatura me ato të CE dhe ISO-t përkatëse si dhe **SUPERVIZIMIT & KOLAUDIMIT** për punimet në objekt.

Tiranë, Dhjetor 2015.



RELACION SHPJEGUES I PROJEKTIT

Hartimi i Projekt-Preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinave të qendrave shëndetësore dhe ambulancave

Qendra Shëndetësore Q/Rubik

Rikonstruksioni i kësaj qendre vjen si rezultat i pasjes së një qendre shëndetësore me funksionim normal dhe me standarte të përcaktuara.

Gjendja ekzistuese ofron kushte shumë të vështira pune dhe jashtë standarteve teknike, gjë që vë në rrezik si punonjësit ashtu edhe pacientët të cilëve i ofrohet shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor.

Qëllimi i këtij rikonstruksioni është krijimi i një qendre shëndetësore, ku të siguroje të gjitha kushtet e nevojshme të shërbimit parësor shëndetësor, rikonstruksionin e plotë dhe rivitalizimin e godinës ekzistuese, si edhe krijimin e një ambjenti të brendshëm dhe të jashtëm si funksional ashtu edhe estetik, me vlera bashkëkohore dhe funksionale.

Projektuesi ka bërë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstruksionin e godinës duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së Institucionit, skemën funksionale të saj, si dhe duke harmonizuar me godinat e tjera të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme.

Sistemimeve të jashtme të objektit i është kushtuar një rëndësi e veçantë, gjithmonë duke patur parasysh nëse territori përreth godinës është në pronësi të vetë qendrës shëndetësore. Ato janë projektuar në përputhje me të gjitha normat e sigurisë dhe standardet e projektimit. Ambientet e jashtme janë kryesisht ambiente që shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë i është dhënë krijimit të një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë.

Një pikë e rëndësishme në hartimin e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës githashtu është edhe përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuar të cilës i është dhënë rëndësi e veçantë, duke realizuar me elementët ndërtimor si pandusi i hyrjes nga niveli i tokës sistemuar deri në kuotën ± 0.00 me pjerrësi max. 5 deri 8 % konform VKM nr.1503 datë 19.11.2008 mbi "Shfrytëzimin e hapsirave nga personat me aftësi të kufizuar", si dhe janë parashikuar të gjithë elementët e tjerë ndërtimor të sinjalitika horizontale dhe vertikale me qëllim që godina e rikonstruktuar të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të vecanta.

Përshkrim mbi punimet kryesore të rikonstruksionit që do të kryhen:

A-Punimet për infrastrukturën ndërtimore.

1. Është parashikuar prishja e të gjithë suvatimeve të brëndshme të cilat janë të amortizuara. Suvatimet e reja do të ribëhen konform K.T.Z. për këtë proces si dhe bazuar në detyrën e projektimit për rikonstruksionin e këtij objekti.
2. Do të prishet H/Izolimi ekzistues i taracës dhe do të ribëhet H/ Izolimi i ri me 2 shtresa k/ katrama me spesor të letrës 4mm e ngjitur me të nxehtë, me shkëlqe të shtresave domosdoshmërisht 8-10 cm mbi njëra-tjetrën, si dhe përdorimin e shtresës anti avulluese dhe vendosjes së shtresës termoizoluese me polisterol trashësi 5 cm. Përpara hedhjes së shtresës së re të k.k do të bëhet shtresa e re me llustër cimento 1:2, niveluese me pjerrësi rreth 2%. Në punimet për rinovimin e taracës do të jenë dhe vendosja e kasetave të reja, si dhe ulluqet vertikale me llamarinë xingato diam. 100 mm me trashësi të saj 0.6 mm

për shkarkimin e ujrave të shiut. Mbulesa e parapetit në taracë do të realizohet me mbulesë mermeri travertine me trashësi 3 cm.

3. Shtresat e pllakave ekzistuese janë të amortizuara, dhe të disa llojeve për shkak të ndërhyrjeve pjesore që janë kryer në objekt. Gjithashtu shtresat ekzistuese do të hiqen edhe për faktin se do të vendosen (shtrihen) nën to linjat e reja për instalimet elektrike, të ngrohje - ftohjes, H/Izolimit të nyjeve higjeno-sanitare etj. Në punimet e shtresave bëjnë pjesë dhe veshja e re e shkallëve me mermer graniti të cilësisë I dhe montimi i korimanove prej inoksi në shkallë dhe sheshpushimet. Për rrjedhojë të gjitha shtresat e dyshemeve do të bëhen të reja, duke i shtruar me pllaka cilësore të ngjitura me kollë. Koridoret do të shtrohen me pllaka graniti $t=2$ cm, ndërsa ambientet e tjera sanitare me pllaka grez porcelanato me sipërfaqe poroze. Ngjyra dhe lloji i pllakës do të përcaktohen nga projektuesi dhe investitori. Në të gjithë ambientet ku shtrohen pllaka do të ketë dhe F-v plintusa me $h=10$ cm si vetë pllaka.
4. Në punimet e ribërjes së suvatimeve të reja kujdes i vecantë do ti kushtohet cilësisë së suvatimit me fino me pluhur guri të imët. Sipërfaqja e re e suvatuar përpara lysterjes do të pastrohet mirë me zmerilim me letër dhe do të lyhet me 1 dorë prajmer dhe 2 duar hidromat plastiko (cil.I) pa përmbajtje të elementëve bakterial si dhe do kryhet lysterja me bojë akrilike të mureve të brendshme nga dyshemeja deri në lartësinë 150 cm.
5. Të gjitha ambientet e nyjeve sanitare do të vishen me pllaka të reja deri në lartësinë 2.5 m. Në këto ambiente pas realizimit të shtresës niveluese të llustrës me t -mesatare 2-3cm, ato do të hidroizolohen me 1d emulsion (prajmer) dhe 1 shtresë k.katrama me ngjitje me të nxehtë, ku lartësia e h/izol mbi kuoten e dyshemesë së mbaruar të nyjes sanitare, do të jetë deri rreth 50 cm. Mbi shtresën e k.k do të realizohet shtresa e e dytë e llustrës me $t=2$ cm. Llustra detyrimisht të jetë llustër cemento në raport 1:2 (rërë/cimento).
6. Në muret e katit përdhe ka shenja lagështie (kapilaritet të ujit) për rrjedhojë do të kryhen punime të cilat do të disiplinonjë prezencën e lagështisë në muret e katit përdhe.
7. Si të tilla do të jenë punimet e sistemimeve të jashme si riasfaltimi i ri në të tre anët e godinës në zonat të vecanta ku do të kryhen punime e reja, sic është ndërtimi i sistemit të ri ujëmbledhësi për ujrë sipërfaqësor duke ndërtuar kumetë të re mbrojtëse me b/arme M-200Kg/cm² e mbuluar me zgarë metalike. Do të bëhet trotuari perimetral rreth godinës të shtruar këto me pllaka betoni me ngjyra. Në katin përdhe një ndër shkaqet e cedimit të dyshemesë në zona të vecanta është dhe difektimi i tubacioneve të k.u.z. ekzistuese, prandaj dhe është menduar për rinovimin e tyre me tuba të rinj dhe puseta kontrolli.
8. Në fasadën e objektit do të prishen suvatimet ekz. që janë të amortizuara. Suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të ketë kombinime për efekte arkitekturore dhe funksionale sic është veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agjentëve atmosferik.
9. Lidhur me furnizimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve në objekt është parashikuar që ato të vendosen të reja. Dritaret do të jenë duro plastike me dopio xham dhe gominë nga të dy anët, me hapje me rotullim dhe praktike në pastrim. Lidhur me ngjyrën e dritareve ajo do të realizohet e bardhë duke qëndruar uniformë me godinat tjera e këtij funksioniiden. Në proj. dhe prev. është parashikuar të vendosen dhe montohen rrjetë mizash në elementët e dritares, të projektuara si të hapëshme (kanata apo sopra luçe). Në pjesën e kontaktit të dritares me davancalin e mermerit të bëhet silikonimi për të penguar depërtimin e ujit. Dyert rekomandohen të jenë me ngjyrë të bardhë ose një ngjyrë shumë e hapur. Dyert e nyjeve sanitare për mbylljen e tyre të jenë me shul të inkasuar në derë (jo me celës).
10. Realizimi i detajeve ndërtimore për Personat me aftësi të kufizuar (p.a.k.), për ndërimin e pandusit do realizohet me themel e xokol betoni C- 12/15 në rastet e kur disnivele është më pak se 50 cm dhe me soleta të plota b/a C 20/25 me trashësi 10 cm për lartësitë deri në 4 m

B- Punimet instalatore dhe teknologjike.

1- Punimet elektrike.

Në projekt preventivin bashkëngjitur, do të gjeni fletët e projektit të detajuara për punimet elektrike. Punimet elektrike janë parashikuar të ribëhen të reja për arsye të amorizimit të atyre ekzistuese, si dhe për garantimin e rritjes së fuqisë së re të instaluar, e cila do të shoqërohet dhe me ndërhyrje dhe rinovim të automatëve kryesor në kabinën elektrike ose në secilin kat. Për zbatimin e punimeve të reja elektrike, materialet e perdurura duhet të jenë konform normave të projektuara (shikoprojektin) si dhe kërkesave bashkëkohore të C.E por dhe ato shqiptare të përshtatura për këto punime. Kujdes i vecantë duhet ti kushtohet realizimit të

sistemit të tokëzimit. Ndriculesat në dhoma janë parashikuar të vendosen mbi kokën e pacientit në $h=2.5$ m dhe të komandushëm nga ky i fundit me celes 1 polar me $h=1$ m nga dysHEMEJA. Ndricimi në koridore dhe në ambientet e tjera është parashikuar të realizohet me llampa ekonomike (luminishente) dhe të llojit sic përcaktohen në projekt.

2- Punimet e kondicionimit Ngrohje-Ftohje.

Për sistem ngrohje në periudhën e dimrit është përdorur ngrohja me gaz vetëm në disa ambiente duke plotësuar vetëm 20% të nevojave godinës. Nisur nga kjo situatë u projektua një sistem Ngrohje-Ftohje dhe Aspirimi me kondicioner inverter

3- Instalimet H/sanitare dhe shkarkimeve.

Për instalimet H/sanitare është parashikuar që keto të ribëhen komplet të reja për shkak të amortizimit të tyre, por dhe mosgarantimit në vazhdimësi funksionimin normal për shkak të cilësisë së dobët që kanë pasur këto tubacione dhe pajisje të cilat në kushtet e sotme nuk plotësojnë as parametrat më minimal të standarteve shqiptare të përshtatura me normat dhe ISO-t e CE. Pajisjet H/S janë parashikuar të jenë me material porcelan. Tubat e shkarkimit do të jenë tub PPV 40x3.2mm referuar iso/dis 3633. Tubat e shkarkimeve vertikale do jenë me tuba PVC me spesor 3mm. Bashkimet të bëhen me ngjitës pvc të lëngshëm special. Kollonat vertikale do të dalin për cfyrje të gazrave në taracë.

Ndër punimet e tjera H/sanitare janë dhe tubacionet e furnizimit dhe të shpërndarjes me ujë të pishëm. Furnizimi i objektit me ujë është parashikuar të bëhet në dy mënyra, me furnizim direkt nga rrjeti dhe sitem të kombinuar rezervuar-pompë shtytëse me rezervuar xingato 5000 l c-2-3 dhe pompa shtytëse me kap. $Q=120$ l/min dhe $h=30$ m. Njëri nga rezervuarët dhe 1 pompë do të shërbejë i pavarur dhe enkas për sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Tubacionet do të jenë prej material polipropileni dhe ngjitje me të nxehtë në gjatësi dhe bashkuere polipropileni me fileto. Objekti do të paiset me kontaktor (matës) të ri. Tubat do të kenë diametra sic janë në projekt nga $D=20 \times 4.1$ mm deri $d=63 \times 10.5$ mm. Para përfundimit të shtresave të bëhen provat me ngarkesë me presion max 1.5-2 atm se presioni normal. Furnizimi i pompave të ujit me energji të garantohet duke u lidhur dhe me burimin rezervë të energjisë gjeneratorin dizel. Për rastin e furnizimit me ujë të vendosen saracineska bronxi kontrolli dhe funksionale në raste avarie. Gjithashtu janë planifikuar të vendosen pika kontrolli me fileto ose gominë në tubacionet e shkarkimit ujrave të zeza. Tubacionet e ujit të pishëm mbi tavanet dhe në mure të sistemohehen me konstruksione metalike ose të kapura me grapeta cdo 1.5m.

SHENIM:

Për sqarime dhe detajime më të hollësishme përvec se ato që përshkruajnë projektet e zbatimit dhe preventivi, si dhe specifkimet teknike përkatëse, për cdo paqartësi apo sygjerim të mos veprohet pa u konsultuar paraprakisht me investitorin dhe supervizorin. Pjesë e dokumentave për porositësin është dhe grafiku i punimeve i hartuar nga grupi i projektimit i cili përcakton kohëzgjatjen e punimeve. Për të gjitha punimet e përshkruara më lart dhe në vazhdim sipërmarrësi do të hartojë plan organizimin e punimeve i cili duhet të shërbejë jo vetëm si masë organizative për realizimin e punimeve në afat, por edhe për aktivitetin normal të veprimtarisë së qendrës dhe përrreth tij, por njëkohësisht dhe si tregues dhe zbatues i masave për sigurimin teknik të Specialistëve+Puntorëve të zbatimit, si dhe të personelit që lëviz përreth objektit. Për të gjithë zërat e punimeve të përshkruara në preventiv dhe projekt sipërmarrësi është i detyruar të kryej punimet e zbatimit, konform një plan organizimi të punimeve në kantier si dhe ligjeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë **KUSHTET TEKNIKE TE ZBATIMIT (K.T.Z) TË PRODHIMIT DHE FURNIZIMIT ME MATERIALE** të certifikuara **KONFORM NORMAVE SHQIPTARE** sipas STASH dhe të përshtatura me ato të CE dhe ISO-t përkatëse si dhe **SUPERVIZIMIT & KOLAUDIMIT** për punimet në objekt.

Tiranë, Dhjetor 2015.



" VIANTE Konstruksion " Sh.p.k.
RELACION SHPJEGUES I PROJEKTIT

*Hartimi i Projekt-Preventivit të zbatimit për
rikonstruksionin e godinave të qendrave
shëndetësore dhe ambulancave*

Qendra Shëndetësore Iballë



Rikonstruksioni i kësaj qendre vjen si rezultat i pasjes së një qendre shëndetësore me funksionim normal dhe me standarte të përcaktuara.

Gjendja ekzistuese ofron kushte shumë të vështira pune dhe jashtë standarteve teknike, gjë që vë në rrezik si punonjësit ashtu edhe pacientët të cilëve i ofrohet shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor.

Qëllimi i këtij rikonstruksioni është krijimi i një qendre shëndetësore, ku të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme të shërbimit parësor shëndetësor, rikonstruksionin e plotë dhe rivitalizimin e godinës ekzistuese, si edhe krijimin e një ambjenti të brendshëm dhe të jashtëm si funksional ashtu edhe estetik, me vlera bashkëkohore dhe funksionale.

Projektuesi ka bërë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstruksionin e godinës duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së Institucionit, skemën funksionale të saj, si dhe duke harmonizuar me godinat e tjera të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme.

Sistemimeve të jashtme të objektit i është kushtuar një rëndësi e veçantë, gjithmonë duke patur parasysh nëse territori përreth godinës është në pronësi të vetë qendrës shëndetësore. Ato janë projektuar në përputhje me të gjitha normat e sigurisë dhe standardet e projektimit. Ambientet e jashtme janë kryesisht ambiente që shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë i është dhënë krijimit të një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë.

Një pikë e rëndësishme në hartimin e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës githashtu është edhe përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuar të cilës i është dhënë rëndësi e veçantë, duke realizuar me elementët ndërtimor si pandusi i hyrjes nga niveli i tokës sistemuar deri në kuoten ± 0.00 me pjerrësi max. 5 deri 8 % konform VKM nr.1503 datë 19.11.2008 mbi "Shfrytëzimin e hapsirave nga personat me aftësi të kufizuar", si dhe janë parashikuar të gjithë elementët e tjerë ndërtimor të sinjalitika horizontale dhe vertikale me qëllim që godina e rikonstruktuar të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të vecanta.

Përshkrim mbi punimet kryesore të rikonstruksionit që do të kryhen:

A-Punimet për infrastrukturën ndërtimore.

1. Është parashikuar prishja e të gjithë suvatimeve të brëndshme të cilat janë të amortizuara. Suvatimet e reja do të ribëhen konform K.T.Z. për këtë proces si dhe bazuar në detyrën e projektimit për rikonstrukcionin e këtij objekti.
2. Do të hiqet çatia dhe do të bëhet rikonstrukcion i plote i çatise.
3. Shtresat e pllakave ekzistuese janë të amortizuara, dhe të disa llojeve për shkak të ndërhyrjeve pjesore që janë kryer në objekt. Gjithashtu shtresat ekzistuese do të hiqen edhe për faktin se do të vendosen (shtrihen) nën to linjat e reja për instalimet elektrike, H/Izolimit të nyjeve higjieno-sanitare etj. Në punimet e shtresave bëjnë pjesë dhe veshja e re e shkallëve me mermer graniti të cilësisë I dhe montimi i korimanove prej inoksi në shkallë dhe sheshpushimet. Për rrjedhojë të gjitha shtresat e dyshemeve do të bëhen të reja, duke i shtruar me pllaka cilësore të ngjitura me kollë. Ambientet sanitare do të shtrohen me pllaka grez porcelanato me sipërfaqe poroze. Ngjyra dhe lloji i pllakës do të përcaktohen nga projektuesi dhe investitori. Në të gjithë ambientet ku shtrohen pllaka do të ketë dhe F-v plintusa me $h=10$ cm si vetë pllaka.
4. Në punimet e ribërjes së suvatimeve të reja kujdes i vecantë do të kushtohet cilësisë së suvatimit. Sipërfaqja e re e suvatuar përpara lyerjes do të pastrohet mirë me zmerilim me letër dhe do të lyhet me 1 dorë prajmer dhe 2 duar hidromat plastiko (cil.I) pa përmbajtje të elementëve bakterial si dhe do kryhet lyerja me bojë akrilike të mureve të brëndshme nga dyshemeja deri në lartësinë 150 cm.
5. Në fasadën e objektit do të prishen suvatimet ekz. që janë të amortizuara. Suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të ketë kombinime për efekte arkitekturore dhe funksionale sic është veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agjentëve atmosferik.
6. Të gjitha ambientet e nyjeve sanitare do të vishen me pllaka të reja deri në lartësinë 2 m. Në këto ambiente pas realizimit të shtresës niveluese të llustrës me t-mesatare 2-3cm, ato do të hidroizolohen me emulsion me dy duar bitum ku lartësia e h/izol mbi kuoten e dyshemesë së mbaruar të nyjes sanitare, do të jetë deri rreth 50 cm. Mbi shtresën do të realizohet shtresa e e dytë e llustrës me $t=2$ cm. Llustra detyrimisht të jetë llustrë cimento në raport 1:2 (rërë/cimento).
7. Në muret e katit përdhe ka shenja lagështie (kapilaritet të ujit) për rrjedhojë do të kryhen punime të cilat do të disiplinonjë prezencën e lagështisë në muret e katit përdhe.
8. Si të tilla do të jenë punimet e sistemimeve të jashme si riasfaltimi i ri në të tre anët e godinës në zonat të vecanta ku do të kryhen punime e reja, sic është ndërtimi i sistemit të ri ujëmbledhësi për ujrat sipërfaqësor duke ndërtuar kunetë të re mbrojtëse me $b/arme$ M-200Kg/cm² e mbuluar me zgarë metalike. Do të bëhet trotuari perimetral rreth godinës të shtruar këto me pllaka betoni me ngjyra. Në katin përdhe një ndër shkaqet e cedimit të dyshemesë në zona të vecanta është dhe difektimi i tubacioneve të k.u.z. ekzistuese, prandaj dhe është menduar për rinovimin e tyre me tuba të rinj dhe puseta kontrolli.

9. Në fasadën e objektit do të prishen suvatimet ekz. që janë të amortizuara. Suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të ketë kombinime për efekte arkitekturore dhe funksionale sic është veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agjentëve atmosferik.
10. Lidhur me furnizimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve në objekt është parashikuar që ato të vendosen të reja. Dritaret do të jenë duro plastike me dopio xham dhe gominë nga të dy anët, me hapje me rrotullim dhe praktike në pastrim. Lidhur me ngjyrën e dritareve ajo do të realizohet e bardhë duke qëndruar uniformë me godinat tjera e këtij funksioniiden. Në proj. dhe prev. është parashikuar të vendosen dhe montohen rjetë mizash në elementët e dritares, të projektuara si të hapëshme (kanata apo sopra luce). Në pjesën e kontaktit të dritares me davancalin e mermerit të bëhet silikonimi për të penguar depërtimin e ujit. Dyert rekomandohen të jenë me ngjyrë të celët. Dyert e nyjeve sanitare për mbylljen e tyre të jenë me shul të inkasuar në derë (jo mecelës).
11. Realizimi i detajeve ndërtimore për Personat me aftësi të kufizuar(p.a.k.), për ndërimin e pandusit do realizohet me themel e xokol betoni C- 12/15 në rastet e kur disniveli është më pak se 50 cm dhe me soleta të plota b/a C 20/25 me trashësi 10 cm për lartësitë deri në 4 m.

B- Punimet instalatore dhe teknologjike.

1- Punimet elektrike.

Në projekt preventivin bashkëngjitur, do të gjeni fletët e projektit të detajuara për punimet elektrike. Punimet elektrike janë parashikuar të ribëhen të reja për arsye të amorizimit të atyre ekzistuese, si dhe për garantimin e rritjes së fuqisë së re të instaluar, e cila do të shoqërohet dhe me ndërhyrje dhe rinovim të automatëve kryesor në kabinën elektrike ose në secilin kat. Për zbatimin e punimeve të reja elektrike, materialet e perdurura duhet të jenë konform normave të projektuara (shikoprojektin) si dhe kërkesave bashkëkohore të C.E por dhe ato shqiptare të përshtatura për këto punime. Kujdes i vecantë duhet ti kushtohet realizimit të sistemit të tokëzimit. Ndriculesat në dhoma janë parashikuar të vendosen mbi kokën e pacientit në $h=2.5$ m dhe të komandushëm nga ky i fundit me celes 1 polar me $h=1$ m nga dyshemeja. Ndricimi në koridore dhe në ambientet e tjera është parashikuar të realizohet me llampa ekonomike (luminishente) dhe të llojit sic përcaktohen në projekt.

2- Punimet e kondicionimit Ngrohje-Ftohje.

Për sistem ngrohje në periudhën e dimrit është përdorur ngrohja me gaz vetëm në disa ambiente duke plotësuar vetëm 20% të nevojave godinës. Nisur nga kjo situatë u projektua një sistem Ngrohje-Ftohje dhe Aspirimi me kondicioner inverter.

3- Instalimet H/sanitare dhe shkarkimeve.

Për instalimet H/sanitare është parashikuar që keto të ribëhen komplet të reja për shkak të amortizimit të tyre, por dhe mosgarantimit në vazhdimësi funksionimin normal për shkak të cilësisë së dobët që kanë pasur këto tubacione dhe pajisje të cilat në kushtet e sotme nuk plotësojnë as parametrat më minimal të standarteve shqiptare të përshtatura me normat dhe ISO-t

e CE. Pajisjet H/S janë parashikuar të jenë me material porcelan. Tubat e shkarkimit do të jenë tub PPV 40x3.2mm referuar iso/dis 3633. Tubat e shkarkimeve vertikale do jenë me tuba PVC me spesor 3mm. Bashkimet të bëhen me ngjitës pvc të lëngëshëm special. Kollonat vertikale do të dalin për cfryrje të gazrave në taracë.

Ndër punimet e tjera H/sanitare janë dhe tubacionet e furnizimit dhe të shpërndarjes me ujë të pishëm. Furnizimi i objektit me ujë është parashikuar të bëhet në dy mënyra, me furnizim direkt nga rrjeti dhe sitem të kombinuar rezervuar-pompë shtytëse me rezervuar xingato 5000 l c-2-3 dhe pompa shtytëse me kap. $Q=120l/min$ dhe $h=30m$. Njëri nga rezervuaret dhe 1 pompë do të shërbejë i pavarur dhe enkas për sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Tubacionet do të jenë prej material polipropileni dhe ngjitje me të nxehtë në gjatësi dhe bashkuese polipropileni me fileto. Objekti do të paiset me kontator (matës) të ri. Tubat do të kenë diametra sic janë në projekt nga $D=20 \times 4.1mm$ deri $d=63 \times 10.5mm$. Para përfundimit të shtresave të bëhen provat me ngarkesë me presion max 1.5-2 atm se presioni normal. Furnizimi i pompave të ujit me energji të garantohet duke u lidhur dhe me burimin rezervë të energjisë gjeneratorin dizel. Për rastin e furnizimit me ujë të vendosen saracineska bronxi kontrolli dhe funksionale në raste avarie. Gjithashtu janë planifikuar të vendosen pika kontrolli me fileto ose gominë në tubacionet e shkarkimit ujrave të zeza. Tubacionet e ujit të pishëm mbi tavanet dhe në mure të sistemohen me konstruksione metalike ose të kapura me grapeta cdo 1.5m.

SHENIM:



Për sqarime dhe detajime më të hollësishme përvec se ato që përshkruajnë projektet e zbatimit dhe preventivi, si dhe specifikimet teknike përkatëse, për cdo paqartësi apo sygjerim të mos veprohet pa u konsultuar paraprakisht me investitorin dhe supervizorin. Pjesë e dokumentave për porositësin është dhe grafiku i punimeve i hartuar nga grupi i projektimit i cili përcakton kohëzgjatjen e punimeve

Për të gjitha punimet e përshkuara më lart dhe në vazhdim sipërmarrësi do të hartojë plan organizimin e punimeve i cili duhet të shërbejë jo vetëm si masë organizative për realizimin e punimeve në afat, por edhe për aktivitetin normal të veprimtarisë së qendrës dhe përreth tij, por njëkohësisht dhe si tregues dhe zbatues i masave për sigurimin teknik të Specialistëve+Puntorëve të zbatimit, si dhe të personelit që lëviz përreth objektit. Për të gjithë zërat e punimeve të përshkuara në preventiv dhe projekt sipërmarrësi është i detyruar të kryej punimet e zbatimit, konform një plan organizimi të punimeve në kantier si dhe ligjeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë **KUSHTET TEKNIKE TE ZBATIMIT (K.T.Z) TË PRODHIMIT DHE FURNIZIMIT ME MATERIALE** të certifikuara **KONFORM NORMAVE SHQIPTARE** sipas **STASH** dhe të përshtatura me ato të **CE** dhe **ISO-t** përkatëse si dhe **SUPERVIZIMIT & KOLAUDIMIT** për punimet në objekt.


Tiranë, Dhjetor 2015.

PLANIMETRIA, SH 1:100

OBJEKTI:, MURE BUTO/BETONI MBAJTËS PËR OBJEKTIN QENDRA SHENDETËSORE IBALLE



PRËRJA TËRTHORE SKEMATIKE E MURIT MBAJTËS
TE QENDRES SHENDETËSORE IBALLE



PUNOI:

Ing. Aurela DODA

Ing. Tonin PRENGA



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Tel:027123131, email: bashkiafushearrez@hotmail.com

Nr. 41 prot

Fushe-Arrez me 06.01.2022

RELACION

Mbi domosdoshmerine e realizimit te disa punimeve shtese ne objektin :
"Rikonstruksion i Qendres Shendetesore, fshati Iballe, Njesia Administrative
Iballe.

Per te realizuar me cilesi dhe sipas KTZ-se te punimeve ne objektin e mesiperm
nevojiten keto punimr shtese:

1. Punime per mbrojtjen e truallit te objektit, kjo per shkak se anen jugore te tij
trualli ka ulje duke çeduar ne disa pjese te tij.
Kjo vihet re ne plasaritje te muratures rrethuese te objektit dhe te dyshemese
se tij. Per kete eshte planifikuar ndertimi I nje muri butobetoni ne largesi
prej 2m nga fasada jugore e objektit.
Kete fakt e favorizon edhe pjerresia e shpatit ne anen jugore te objektit dhe
eshte e domosdoshme nivelimi i tij me ndertimin e ketij muri.
Per kete eshte hartuar preventive ne Shumen prej 418.752 leke pa TVSH.
2. Ne faqen ballore te objektit paralel me rrugen auto ne te dyja anet e hyrjes
per ne objekt ekzistojne formacione te infiltrueshme, qe rrezikojne
deportimin e ujerave te shiut ne brendesi te objektit, kete e favorizon e
terreni i pjerret ne raport me kuoten e rruges. Per kete eshte e nevojshme
shtrimi me shtrese betoni monolit ne oborrin para objektit.
3. Meqenese objekti do rikonstruktohet plotesisht dhe zona ku ndodhet objekti
eshte me reshje te shumeta shiu eshte e nevojshme qe korniza e çatise te
ndertohet prej materiali kartonxhes çimentato ne gjeresi prej 50 cm nga faqja
anesore e murit.

4. Meqenese ne fshatin Iballe nuk ekziston nje rrjet unik I administrimit te ujerave te perdorura eshte e domosdoshme qe ky sherbim te realizohet nepermjet ndertimit te nje grope septike me volum 8 m3.

Perfundimisht shtesa e ketyre punimeve krahas atyre te parashikuara do te realizonte nje objekt funksional dhe estetikisht mire.

KRYETARI

FRAN TUCI

